

G-Project shpk

PRIZREN

RAPORT

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR THËRRMIMIN DHE SEPERIMIN E GURIT GËLQEROR -
RËRES- ZHAVORIT DHE INERTEVE NË ZHUR, K.PRIZREN

Dhjetor,2025

Kompania G-Project shpk Prizren, për kryerjen e Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror - rëres, zhavorrit dhe inerteve në lokalitetin e Zhurit , komuna Prizren, autorizon Sami Heten me nr. te licences9/16, e vlefshme prej 19.06.2020 deri me 19.06.2025:

Investitori: G-Project shpk
Genc Besimi

Hartuar nga personi i Licencuar

Sami Heta_____
+38344170911 & +38349170911
samibheta@hotmail.com
samibheta@gmail.com

Përmbajtja

	faqe
1. Hyrje	5
2. Baza ligjore për hartimin e raportit.....	6
3. Përshkrimi lokacionit dhe mjedisit.....	9
3.1. Pozita gjeografike e lokacionit	9
3.2. Popullata dhe Vendbanimet.....	13
3.3. Infrastruktura ekzistuese.....	14
3.4. Kushtet klimatike.....	14
3.5. Erërat	15
3.6. Relievi	15
3.7. Hidrogjeologjia	15
3.8. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit	16
3.9. Natyra dhe biodiversiteti	20
3.10. Bimësia dhe vegjetacioni.....	20
3.11. Bota shtazore –fauna.....	21
3.12. Karakteristikat Sizmike	21
3.13. Peizazhi	22
3.14. Ajri	22
3.15. Uji.....	23
4. Përshkrimi i procesit për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror.....	23
4.1. Përshkrimi i gurthyesit me seperacion dhe pajimeve përcjellëse.....	24
4.1.1 Pershkrimi i metodave apo deshmive të paeashikimeve për të pacaktuar pasojat e mjedisore duke përfshi pershkrimin e hollsisht të vështersive pershkrimin e Lokacionit.....	24
4. 2. Procesi teknologjik i gurthyesit me seperacion	24
5.0. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis	27
5.1. Ndikimet në ajër.....	29
5.2. Ndikimet në tokë	29
5.3. Ndikimet në ujë.....	29
5.4. Ndikimet në peizazh.....	30

5.5. Ndikimet në florë dhe aunë.....	30
5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	30
5.7. Zhurma	30
5.8. Ndikimet në raste aksidenteve mjedisore.....	31
6.0 Marja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve.....	32
6.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit	32
6.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës	35
6.3 Masat e marura për mbrojtjen e ujit	36
6.4. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma	38
6.5. Masat e marura për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore.....	38
6.6. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale.....	38
7.0. Programi i monitorimit	39
8.0. Raportimi	39
9.0. Marja e masave rehabilituese pas përfundimit të aktiviteteve thërmuese dhe seperuese	39
9.1. Objektivat e rikultivimit	39
9.2. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve	40
9.3. Rikultivimi teknik	40
9.4. Rikultivimi agroteknik	41
9.5. Rikultivimi biologjik	42
10.0 Monitorimi pas përfundimit të aktivitetit të gurthyesit me seperacion.....	43
11.0. Konkluzion... ..	43
12. Plani investiv.....	44

1. Hyrje

Në kuadër të aktiviteteve për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve në lokalitetin e Zhurit, komuna e Prizrenit, Kompania G-Project shpk Prizren, me z. Genc Besimi drejtor i kompanisë në programin investiv ka paraparë hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për të aplikuar për Pëlqim Mjedisor, i cili është një dokument i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për marrjen e licencës (lejës) për gurthyesin me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve në lokalitetin e Zhur, komuna e Prizren.

Ne raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të analizohen karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokacionin ku është i vendosur gurthyesi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inzhinjeroko- teknologjike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, shtrohet nevoja për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ku do të identifikohen të gjitha ndikimet relelevante që mund të paraqiten në relacionin gurthyes me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve dhe mjedisi, duke mos anashkaluar edhe regjionin e gjerë.

Duke u nis nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis bëhet me qëllim të identifikimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative gjatë thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror.

Me rastin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve, gjatë fazës së realizimit të procesit teknologjik gjatë thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror dhe pas përfundimit të aktiviteteve për realizimin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, kurse ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së vendosjes së gurthyesit me seperacin për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve nuk është marr për bazë, se ne kohen kur është hartuar Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ka qen

i vendosur gurthyesi me seperacin për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve në Zhur, komuna e Prizren.

2. Baza ligjore për hartimin e raportit

Ne lidhje me vlerësimin e ndikimit ne mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis Nr. 08/L-181, i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis Nr. 08/L-181, ka për qëllim për te siguruar mundësimin e një vlerësimi te përgjithshëm me ndërthurje te ndikimeve mjedisore te projekteve apo veprimtarive qe do te realizohen me qëllim qe te parandalojnë dhe te zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative ne mjedis ne kohen e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve edhe at :

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjer në kufijtë e lejuar.

2.1 Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të Raportit të VNM -së për gurthyesin me seperacion janë marrë për bazë ligjet me te rëndësishme te aplikuar qe do të shënohen më poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për mbrojtjen e ajrit Nr. 03/L- 160

- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2016 për pengimin e aksidentev të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.
- Udhëzim administrativ (qrk) - nr. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzim administrativ (qrk) nr.08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzim administrativ mmph - nr. 10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale
- udhëzim administrativ nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave
- Udhëzim administrativ (qrk) nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes

b) Dokumentacioni teknik

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kvantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik .

Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion. Duke i marrë parasysh ndikimet e mundshme gjatë thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, duhet të bëhet vlerësimi i të gjitha ndikimeve të mundshme, dhe duhet parapa masa mbrojtëse të mjedisit.

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos konsultimeve që janë bërë me pronarin dhe me ekspertët që udhëheqin procesin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror si dhe vizitave të bëra në teren, janë shfrytëzuar edhe:

- Projekti teknologjik i gurthyesit me seperacion
- Projekti i maqineris për gurthyesin me seperacion
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Kopja e planit të parcelës
- Plani i situacionit
- Pëlqimi nga komuna e Prizrenit

Krahas parashikimeve themelore nga regullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-s janë shfrytëzuar edhe regullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi.

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-s.

2.2. Metodologjia e Punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për projektin

a) Informatat themelore, që nënkupton identifikimet siç janë:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- Popullata ekzistuese me karakteristikat demografike,
- Karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacion,
- Klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- Kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar,

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve:

- Madhësia dhe lloji i ndotjes
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar

- Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Analiza e rrezikimit të

- Njeriut
- Vlerave materiale
- Vlerave natyrore

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku planifikon të realizohet projekti

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3. Përshkrimi i lokacionit dhe mjedisit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të VNM -së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike

3.1. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni ku do të vendoset gurëthyesi mobil me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve ndodhet, ne lokalitetin Zhur, komuna e Prizren.

Prizreni është qytet në pjesën jug-perëndimore të Republikës së Kosovës.

Lokacioni ku do të vendoset gurëthyysi me seperacion, ndodhet në Zhur, komuna e Prizren, më sakësisht ne kilometrin e e dytë nga dalja e autostradës Ibrahim Rugova nga Prizreni ne drejtim te Morines ne anen e majtë të rrugës magjistrale Prizren - Zhur .

Komuna e Prizrenit ndodhet në pjesën jug-perëndimore të Republikës së Kosovës, si dhe i dyti në Kosovë për nga madhësia dhe popullsia pas Prishtinës. Prizreni po ashtu është qendër e komunës dhe rajonit me të njëjtin emër. Qyteti i Prizrenit ka një popullsi prej rreth 76.850 banorësh, ndërsa komuna ka 147.246, përfshi këtu qytetin dhe 76 fshatrat e Prizrenit. Prizreni gjendet në afërsi të Bjeshkëve të Sharrit në Kosovën jugore, dhe kufizohet me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Qyteti i Prizrenit shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit, në rrugën që lidhte me parë bregdetin verior të tokave shqiptare dhe qendrat e tij qytetaro-tregtare me rajonet e brendshme të Kosovës dhe të Ballkanit.


Lokacioni ku do të vendoset gurëthyysi mobil me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve ë, në pjesën **ngastrës kadastrale nr. 02399-0, 02400-0 ,02401-0, me kulturë mal e klasit 7 me sip S= 1408 m² , nr. P- 71813026-002399-0, me kulturë kulllosë e klasit 7 me sip S= 1901 m² , P- 71813026-02400-0 , P- 71813026-02401-0 me kulturë arë e klasit 7 me sip S= 4516 m², numri i Certifikatave nr 07-029-11096-25 dt 24.11.2025 vendin e quajtur Brija-Oseje, Zona kadastrale Zhur, komuna e Prizren, ngastra kadastrale e lartëcekur është pronë e kompanisë G-Project shpk . Lokacioni për rreth ngastrës ku do të vendoset gurëthyysi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve ndodhet ne lokacion te pa banuar.**

Lokacioni ku do te vendoset Gurthyysi me seperacion, ndodhet në Zhur ne te gjitha anën është i rrethuar me toka bujqesore , por i shpallur nga komuna e Prizrenit Zonë Industriale (ZI) ku ne afërsi operojn edhe katër operator ekonomik me veprimtari te njejtë e që kane distanca ne mes vete te mjaftushme sipas ligjit te KPMM-së.

Kordinatat e gurthyesit me seperacion janë si vijon :

Nr.	Y (m)	X (m)	Nr.	Y (m)	X (m)
1	7469656.540	4670986.018	10	7469782.199	4670988.587
2	7469650.140	4671003.168	11	7469788.839	4670980.487
3	7469674.770	4671006.237	12	7469758.299	4670969.848
4	7469688.920	4671009.817	13	7469737.659	4670965.999
5	7469708.140	4671017.946	14	7469719.729	4670955.099
6	7469724.810	4671029.206	15	7469661.770	4670945.090
7	7469753.930	4671033.705	16	7469658.980	4670963.749
8	7469776.160	4671035.265	17	7469657.800	4670970.799
9	7469781.389	4670993.197			
Siperfaqja 7784.036m ²					

Lokacioni ku do të vendoset gurëthyysi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve shihet ne pjesët e hartave topografike të më poshtme.



Ne bazë të rezervave të gurit gëlqeror dhe bazuar ne pozitën gjeografike të lokacionit që gjendet larg vendbanimeve, ne këte lokacion është duke u bër shfrytëzimi i gurit gëlqeror-rëres dhe zhavorit dhe ne te ardhmen do te ndërtoi gurthyesin me seperacion për thërmimin dhe seperimin, pronari i kompanisë G-Project shpk

Në afërsi të drejtpërdrejt të lokacionit ku do të vendoset gurëthyesi me seperacion për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror -rëres , zhavorit dhe inerteve, nuk ka objekte banimi, objektet më të afërta të banimit gjenden ne një largësi mbi 1700 m. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një lëmi specifike për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror me ndikime kumulative të ndotjes.

3.2. Popullata dhe Vendbanimet

Prizreni është qytet në pjesën jug-perëndimore të Republikës së Kosovës, si dhe i dyti në Kosovë për nga madhësia dhe popullsia pas Prishtinës. Prizreni po ashtu është qendër e komunës dhe rajonit me të njëjtin emër. Qyteti i Prizrenit ka një popullsi prej rreth 76.850 banorësh, ndërsa komuna ka 147.246, përfshi këtu qytetin dhe 76 fshatrat e Prizrenit. Prizreni gjendet në afërsi të Bjeshkëve të Sharrit në Kosovën jugore, dhe kufizohet me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Qyteti i Prizrenit shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit, në rrugën që lidhte me parë bregdetin verior të tokave shqiptare dhe qendrat e tij qytetaro-tregtare me rajonet e brendshme të Kosovës dhe të Ballkanit.

Prizreni bën pjesë në mesin e qyteteve natyrore, ku intervenimi i dorës së njeriut është mjaft i vogël në krahasim me bukuritë që i ka krijuar vetë natyra. Mbi këtë kontekst të përkryer natyror dhe relief mjaft të përshtatshëm gjeografik është ndërtuar e gjithë arkitektura dhe civilizimi shumëshekullor i Prizrenit. Malet e Sharrit shtrihen në jug-lindje të Kosovës duke filluar nga afërsia e Prizrenit dhe shkon pjerrtas me majet apo thepat në formë piramidale të radhitura njëra pas tjetrës apo siç e quante që nga antikiteti populli ilir, majat e sharrës, nga ngjajshmëria në thepat e sharrës, që formojnë figura të njëpasn - jëshme karakteristike në zemër të Ballkanit.

Kultura në Prizren përfaqëson një ndërthurje të pasur të traditës shqiptare, trashëgimisë osmane dhe ndikimeve të tjera ballkanike. I njohur si një ndër qytetet më të vjetra dhe më të bukura të Kosovës, Prizreni është shpesh cilësuar si "kryeqyteti kulturor" i vendit.

Arkitektura e lashtë me xhamitë, kishat dhe urat historike, krijon një peizazh ku historia dhe arti bashkëjetojnë në harmoni.

3.3. Infrastruktura ekzistuese

Sa i përket infrastrukturës ekzistuese, infrastruktura rrugore është e ndërtuar, në afërsi të lokacionit ku do te vendoset gurthyesi me seperacion ne Z. K. Zhur, komuna e Prizrenit, rreth 9 Km në Verilindje te qytetit të Prizrenit.

Lidhjet e komunikacionit me vendburimin janë të favorshme, pasi që lokacioni lidhet me rrugën e cila lidhë Zhurin me Prizrenin dhe Vërmicen , e nga Vërmica lidhet me Autostraden Ibrahim Rugova me të gjithë territorin e Kosovës dhe Shqipërisë, furnizimi me energji elektrike e qendrës bëhet përmes trafos pronë private e pronarit të kompanisë të qendrës, ne këte lokacion .

3.4. Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale.

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë.

Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 11,5°C gjer në 12,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 12,0°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C.

Temperaturat më të ulta janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej -0.5°C.

Regjimi i reshjeve ne komunën e Prizren ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 670 mm deri ne 820 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 66.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2 %.

Në komunën e Prizren e posaçërisht ne afërsi të lokacionit ne fjalë erërat më të shpeshta janë ato veriore me 226‰ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

3.5. Erërat

Në lokacionin ku është i vendosur gurëthyesi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, për shkak të konfiguracionit e posaçërisht pozitës gjeografike më së shumti janë të përfaqësuara erërat veriore.

Me intensitet më të madhe të shpejtësisë paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat perëndimore, kurse ato jugore janë me intensitet më të vogël. Në komunën e Prizren erërat më të shpeshta janë ato veriore me 225‰ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 226‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 4.2 m/sek.

3.6. Relievi

Rajoni i lokacionit ku do të vendoset gurëthyesi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve karakterizohet me një relief te rrafshhtë fushor si dhe kodrinoro malor.

Relievi me larësit, pjerrtësitë dhe ultësirat e ndryshme ndikon ne formimin dhe ndërtimin e elementeve klimatike, ne shfaqjen e të reshurave klimatike dhe formimin e rrjetit ujqor.

3.7. Hidrogjeologjia

Karakteristikat hidrogjeologjike të lokacionit janë të thjeshta. Morfologjia, ndërtimi gjeologjik, tektonika janë faktorët dominantë të cilët definojnë lëvizjen e ujërave sipërfaqësor dhe ato nën tokësor.

Në afërsi të lokacionit ku planifikohet të bëhet thermimi dhe seperimi , burime natyrore të ujit nuk ekzistojnë, për pos, ujërat sipërfaqësore të cilat krijohen gjatë të reshurave atmosferike të cilat drenohen në kanalet natyrale (prrrockat) dhe pastaj drenohen në lumin e Drinit I cili ndhodhet ne distance mbi 3200 m, të gjitha përrockat gravitojnë në drejtim të lumit të Drini i bardhë , që njëherit paraqet edhe ujëmbledhësin kryesor në këtë rajon i

cili është në largësi të pa përfillshme dhe atë në distancë mbi 3200 nga lokacioni ku planifikohet të bëhet themimi dhe seperimi i gurit gëlqeror, reres, zhavorit dhe inerteve. Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Prizrenit është Lumbardhi i Prizrenit, është një lumë në pjesën jugore të Kosovës dhe i cili rrjedh përgjatë Maleve të Sharrit, nëpër fshatrat e Sreckës dhe pasi kalon përmes Prizrenit, derdhet në Drinin e Bardhë. Lumbardhi i Prizrenit është 35.5 kilometres (22 mi) i gjatë dhe ka një sipërfaqe të pellgut prej 279 km² (108 sq mi). Degët më të rëndësishme të Lumbardhit të Prizrenit janë: Shartica, Petroshnica, Drajçica, Lubinja, Jabllanica dhe lumi i Manastirit. Lumbardhi i Prizrenit afër fshatit Muradem derdhet në lumin Drini i Bardhë. Klima e qytetit me rrethinë është jashtëzakonisht e larmishme.

3.8. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit

Në ndërtimin gjeologjik të zones së Zhur-Prizrenit marrin pjesë:

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit të gjërë marrin pjesë këta anëtar gjeologjik:

- **Rreshpet Kristalore**
- **Kretaku I sipërm**
- **Serpentina**
- **Harcburgitet**
- **Diabazët**
- **Formacionet e Neogjenit**
- **Quaternari**

Rreshpet Kristalore (G)

Paraqesin shkëmbinjët më të vjetër në territorin e Kosovës në pjesët e jug-lindore të te neogjenit të Dukagjinit me shtrirje VP-JL3

Pjesa periferike e basenit terciar të Dukagjinit siq shifet nga harta gjeologjike ndërtohet nga rreshpet kristalore. Rreshpet kristalore të grupit të parë paraqesin pjesën më të vjetër të këtij tereni. Në aspektin litologjik paraqesin ortoshkëmbinjët dhe parashkëmbinjët.

Seria e Rreshpeve janë të ndërtuara nga :

- Filitet
- Sericiti
- Rreshpet kloritikeme carbonate

FILITET-Ne serinë metamorfike shkëmbinjët krijojnë të ashtuquajtur "rreshpet e murrme" të cilat ndodhen në dyshemen dhe tavanin e rreshpeve me shkëlqim.

Kontakti i pjesës së dyshemes së filiteve me rreshpet me shkëlqim është i ashpër, ndërsa kufiri i pjesës tavanore është i paqart, arsyeja është ndrrimet e shpeshta të filiteve me sericite dhe rreshpe kuarcit-sericitik.

PERIDOTITET DHE SERPENTINITET -Rrepeshet Palezoike: Rrepeshet palezoike I përkasin serisë së Veleshit siç janë: Rrepeshet biotitike, Albitit-gnajse, Amfibolike sericitike-klorititike, Filite, Argjilet të metamorfizuara, Ranore metamorfik, Konglomerate kuarcore dhe mermeret.

Në disa zona janë të vertetuara rrepeshet liskuinar.

Rrepeshet janë të mbuluara me argjilë të kuqe në të verdhë.

Në zonën e shkëmbinjëve të metamorfizuar janë të konstatuar këta anëtar litologjik:

- Kuarcitet kokërrimët
- Kuarcitet kokërrtrash
- Gëlqeroret e prekristalizuara
- Rrepeshet kloritike-sericitike-albite.

Rrepeshet kloritike-sericitike: albite janë me ngjyrë të gjelbërt me strukturë lepidoballastike. Është ndërtuar nga kuarci kokërrimë. Kloriti dhe liskuni janë më rrallë të përfaqësuar në formë të thirrzave të vogla dhe ndërfaqe si shtresa të holla. Rrepeshet skundre të albit janë pjesërisht të përfshira nga procesi I karbonatizimit, kalciti sekondar shfaqet në formë damarore.

Sedimentet flishore ndërtojnë horizontet më të larta të kompleksit të kretakut të latë. Seria e flishit karakterizohet me ndërtim të tri kateve litologjike: ranorëve, mergeliteve dhe argjilave me varijeteve të tyre.

Në seri dallohen pjesët e poshtme ku dominon komponenti mergelor-argjilor dhe pjesët e sipërme kryesisht me komponentë ranore.

Pjesët më të sipërme veçohen me ranor masiv.

Trashësia e serisë nuk është përcaktuar mirë por ajo vlerësohet nga 500-700m.

Harcburgitet Ndërtojnë pjesët më veriore të rrethinës së gjerë të vendburimit të gëlqerorit dhe paraqesin pjesët më jugore të masivit ultrabazik të Gjakoves.

Përfaqësohen nga harzburgitet e serpentinizuara dhe serpentinet harzburgitet si dhe nga masat e dunitëve, të cilat së bashku paraqesin masën themelore në të cilën janë futur të gjitha varietetet tjera të ultrabazikëve. Këta shkëmbinj janë të ndarë (coptuar) nga sistemet e shumta të çarjeve. Pseudostratifikimi është i shprehur mirë në harzburgite dhe ka drejtim VVP-JJL. Shkëmbinjtë e këtij kompleksi përbëhen nga olivina, enstatiti dhe piroksenët tjerë, ndërsa si përbërës të dorës së dytë paraqiten kromit dhe graniti. Minerale dytësore janë serpentina, talku, kloriti dhe amfiboli dytësorë. Kanë ngjyrë të gjelbër (jeshile), të mbyllët ose të përhimët të mbyllët (harzburgitet e serpentinizuara) deri në të verdhë-gështenjë (dunitet).

Diabazet Janë të lidhura për masivin ofiolitik të zonës së Dragashit që paraqesin sekuencën e korës oqeanike. Përfaqësues kryesor janë Diabazet , që kalojnë më sipër në bazalte. Anëtarët më të vonshëm që janë krijuar janë kuarckkeratofiret që prezantojnë diferenciate acidike të magmatizmit iniciues të zhvilluar gjatë stadiut të pas subduksionit. Jurasiku i Mbuleses sedimentare të ofioliteve të Rajonit të Rahovecit përfaqësohet nga;

Melanzhi “blloqe në matriks”, Formacioni serpentinë - karbonat, Formacioni i silicorëve radiolaritikë dhe Formacioni flishor, ranoro – argjilor (Flishi I Volljakut).

Depozitime të Jurasikut

Ndërtojnë terrenin për rreth serpentiniteteve, në formë të zgjatur të cilat kanë ndikime në zonën tektonike. Kjo njësi litostratigrafike është e përzier nga sedimente të depozituara të materialeve vullkanogjene si diabaze, spilite, tufe diabazike dhe silicium.

Triasiku (T)

Shkëmbinjet me shtrirje më të madhe në këtë zonë i përkasin triasikut . Janë të veqar Triasiku i poshtëm, mesëm dhe i sipërm.

Triasiku i poshtëm- Janë të veqara tri njësi litologjike dhe stratigrafike me antar të ndryshëm: a) facia e kuarcit kllastit , b) facia argjillo – mergelore dhe C). facia karbonatike.

Facia e kuarcit kllastit(T_1)- përfshin një sipërfaqe të madhe në Rugov dhe në fshatin Shtupel, Bogaj deri te lugina e lumit Iber. Vjetersia e sedimentev është përcaktuar në bazë të super pozicionit në raport me dyshtemen dhe tavanit me ternet e afërta të Ivangradit.

Kuaci kllastit shtrihet në mënyr transgresive perms baze të vjeter – rreshpev karbonatike ranore të devonit . Janë të perfaqsuara nga : Kongllemeratet kuarcore brekqet, ranoret dhe argjilliteve.

Shkëmbinjet magmatik- të triasikut të mesem përfshijn sipërfaqe të vogla. Këto janë produkte submarine që fillojnë me ciklus në katin nazik dhe përfundojnë në katin llandin. Në fillim cikli është i qetë, rrjedha e llavës është e me ndërprerje eksplozive, kur dhe janë të krijuar tufitet aglomeratet dhe breqet vullkanike. Përfundimi i Triasikut vullkanik karakterizohet me krijimin e sedimentev vullkanogjene që tufitet zëvendsohen me mergele , argjillite, gëlqeror dhe strallor.

Tufitet, Brekqiet vullkanike dhe Andezitet (α)- këta shkëmbinj janë përcjells të rregullt të kurc keratofirit dhe keratofirit. Këta janë shkëmbinj masiv që në formë makroskopike vështir dallohen nga rrethina e vullkanit. Te tufitet mbizotron variateti litokllastik. Tufitet qfaqen në periudhen përfundimtare të aktivitetit vullkanik. Kanë ngjyrë të gjelbert me tekstur shiritore. Zakonisht ndrohen me strallor mergelor dhe gëlqeror. Këta shkëmbinj kanë përbërje minerale të ngjajshme me rrethinen e vullkanit. Masa çimentuse është silicore sericitike dhe më rrallë tufit kokërrimë.

Kuarckeratofiri, Kratofiri, Tufitet (η) –janë shkëmbinj kompakt me teksturë masive , ngjyrë hiri të shndritshme me shprehje të theksuar të strukturës porfirike. Fenokristalet janë kuarci, albitidhe më rrallë mineralet e ngjyrosura.

Mineralet me ngjyrë si amfiboli dhe biotit janë plotsish të transformuara në klorit me pak oksid hekuri dhe epidot. Baza fillestare është zakonisht kristallore. Poroceset e më vonshme kuarckeratofiri është silifikue, epidotizue, kaolinizue dhe sericitizue.

Triasiku i mesem(T_2) -Në pjesen më të madhe të lokaliteteve të përmendura triasiku i mesem është zhvilluar në facie të gëlqerorit dhe gëlqerorit të dollomitizuar.me shkëmbinjet porfirik shumë ngjyrshë.Prerzenca e t mikrofaunes vërtetohet në katin anezik dhe landik në një hapsir të gjërë,por mungesa e profilev të hapura nuk ka qene mundur që në hartat gjeologjike të veqohen si kate të veqanta.

Triasiku i sipërm T₃)

Triasiku i sipërm Kryisht është i zhvilluar si facie e masivit gelqeror dhedollomit .Ky përfshin zona më të ngushta se sa triasiku i mesëm. Kryesisht ka shtrirje në Koprivnik dhe në malet Lumbardhit si dhe në fillim të Grukës së Rugovës, që vazhdon me shtrirje nga Rrafshi i Dukagjinit, gjithashtu në kodren e Shkozës është i zhvilluar Triasiku i lartë. Në të gjitha zhvillimet, triasiku i sipërm është i perfaqësuar me gelqeror të mermeritizuar dhe dolomite që përmbajnë edhe megallodona. Trashësia arrin deri në 200m.

Nga përbërësit aksesori përbërës më të shpeshtë janë apatiti, zorkoni dhe minerale metalike.

Kretaku-Dominante në formacionet Kretakut janë formacionet karbonatike.

Formacionet karbonatike të kretës së sipërme kanë një zgjatje të mëtejshme gjatë të përgjithshme prej afro 58km. Formacioni i kretakut zhvillohet në anën verilindore të Kosovës dhe kufizohet në përendim me formacionet vullkanogjene të Jures i cili shoqërohet atë në trajtën e një brezi me gjësi 1-2.5km., dhe po thuajse gjatë gjithë gjatësisë duke filluar nga ekstremit lindor në atë përendimor.

Formacionet karbonatike të kretakut të poshtme fillojnë nga juglindor gjegjësisht nga Jura dhe vazhdon me shtrirje nga Gryka e Rugovës e deri në malet e sharrës deri në kufirin ndërshtetror me Maqedonin.

Formacioni i kretakut ka një gjësi në jug 12.5km në pjesën qendrore 15km. Dhe në ekstremin përmyllës në kufirin me Serbi 6km. Në pjesën qendrore të këtij formacioni është e mbuluar me formacionin piroklastit të Tercierit .

3.9. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës , nuk ekzistojnë të dhëna se kjo hapësirë është ndonjë hapësirë e mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është potencial të futet nën mbrojtje .

3.10. Bimësia dhe vegjetacioni

Aktiviteti i gurëthyesit me separacion për thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve në domenin e florës –bimësisë paraqet dukuri që kërkon shqyrtim të kujdesshëm, në kuptim të evidencimit të pasojave të ndryshme të mundshme

negative dhe zvogëlimit të tyre brenda kufijve të pranueshëm. Ajo që dallon florën – bimësinë e këtij regjioni janë ndryshimet intensive si pasojë e veprimtarisë së njeriut.

Në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethin të zonës ku realizohet projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore , manaferra , shkurre dhe malë me rritje mesatare si shkozë, qarr, bung, etj.

Në rrethinë më të largët ekzistojn bimët e ulta barishtore, kultura periodike bujqësore, etj. Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mundë të rrezikohen me funksionimin e gurëthyesit me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve .

Pjesët e ngastrave në fjalë ku është i ndërtuar gurëthyesi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, janë të zhveshura për arsye se ne këte lokacion është duke u shfrytëzuar guri gëlqeror prandaj bimësia nuk ekziston sepse është shkatrruar, pjesët e ngastrave ku është i ndërtuar gurëthyesi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, nuk përmbajnë vlere ekonomike në kuptimin e përdorimit si tokë bujqësore, por as edhe si zone me vlere kullosore. Por kjo zonë për shkak të pozitës gjeografike dhe rezervave të gurit gëlqeror është duke u shëndrruar ne zonë industriale, për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit gëlqeror.

3.11. Bota shtazore – Fauna

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të Zhur , e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë përpos kafshëve dhe shpendëve shtëpiake jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpira, iriqi etj. Prej brejtësve jetojnë- mijtë , prej zvarranikëve- gjarpri i zakonshëm , bolla , breshkat e tokës zhapini i gjelbër , insektet krahëfortë , krahëlusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, çafkat , bilbilat , thëllënëza e fushës , sorrat , shqiponja , etj.

3.12. Karakteristikat Sizmike

Sizmikja mikro-regjionale e këtij lokacioni dallohet me mundësi të dridhjeve të tokës të intensitetit prej 7- 8 shkallë të Merkalit .

Sipas hartave sizmike të regjionit , hapësira e gjerë e hulumtuar nuk i përket një intensiteti të njëjt të dridhjeve sepse varet nga karakteristikat gjeologjike të tokës, thellësisë së ujërave nëntokësore etj.

3.13. Peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin gurëthyesi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve – mjedisi.

Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive . Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Projekti i lartë shënuar gurëthyesi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve nuk ka ndonjë ndikim negativ të theksuar në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, sepse është ndërtuar në lokacionin ku ka qenë i ndërtuar gurëthyes me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve edhe më heret nga një kompani tjetër dhe në efektet vizuale nuk do të ketë ndikime negative se është mësuar shikuesi me këtë gjendje të mjedisit.

3.14. Ajri

Në lokacionin ne fjalë deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku është i ndërtuar gurëthyesi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror.

Nga vet konfiguracioni i terenit kodrinoro-fushor si dhe mos ekzistimit të objekteve industriale përpos gurëthyesit me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,rëres , zhavorit dhe inerteve që ndikojn në ndotjen e ajrit, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit ne afërsi të lokacionit është në nivel të lakmueshëm. Ndotja e ajrit ndodh edhe nga frekuenca e automjeteve ne rrugën rajonale Prizren-Prishtinë, ndotja e

pjesërishme e ajrit vjen nga mekanizmi të cilët përdorën për kryerjen e aktiviteteve bujqësore

3.15. Uji

Ndotja e ujit shkaktohet nga trafiku i cili zhvillohet në rrugën rajonale Prizren-Zhur dhe nga shpërlarja e trasës së rrugës me të reshurat atmosferike.

Ndotja e ujit pjesërisht shkaktohet edhe nga lëshimi i ujërave të zeza nga komuniteti të pa trajtuara si dhe hedhja e mbeturinave në shtratin e lumit dhe përskaaj tij.

4. Përshkrimi i procesit për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror


4.1. Përshkrimi i gurthyesit me seperacion dhe pajimeve përcjellëse

Pronari i kompanisë „G-Project „shpk” për realizimin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror „rëres”, zhavorit dhe inerteve në Zhur posedon këto pajime të cilat do të vendosen në pjesët e ngastrave të lartshënuara:

Gurthyesi mobil Kleemann viti i prodhimit 2025 i cili është i paisur me:

Bunkerin (fyrtnën) me vëllim prej 20m^3 , për pranim të materialit i cili thërrmohet, dozatorin (dhënësin) vibrues, për përcjelljen e materialit prej bunkerit në thërrmuese, transportuesi shiritor për bartje të materialit steril, thërmuesja primare me nofulla, me kapacitet teorik $180\text{-}210\text{m}^3$ në orë, me kapacitet prodhues $130\text{-}150\text{m}^3$ në orë, transportuesit shiritor për bartje të materialit nga thërmuesja nofulllore në gurthyesin sekondar me qeqiqa me traj me kapacitet teorik 80m^3 në orë, me kapacitet prodhues $60\text{-}70\text{m}^3$ në orë i prodhuar nga prodhuesi i Mob cat mc 100, pastaj ekziston transportuesi shiritor për bartje të materialit nga thërmuesja sekondare me qeqiqa në sitën vibruese, pastaj ekzistojnë edhe shiritat transportues përmes të cilave materiali i seperuar transportohet në deponit adekuate, për deponimin e fraksioneve.

Në fotot në vijim shihet gurthyesi me seperacion në pozita të ndryshme



4.1.1 Pershkrimi i metodave apo deshmive të paeashikimeve për të pacaktuar pasojat e mjedisore duke përfshi pershkrimin e hollsisum të veshtersive përshkrimin e Lokacionit.

Lokacioni ku investitori planifikon të bëjë eksploatimin themimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ,reres,zhavorit dhe inertevegjendet ne lokalitetin e fshatit Zhur komuna e Prizrenit.

Nga qendra komunale e Prizrenit ndodhet në largësi rreth 10 km në pjesen perendimore, pra në hyrje te fshatit ne anën e majtë te rrugës Qafa e Zhurit , e cila lidhë autostradën Ibrahim Rugova me fshatin Zhur.

Lokaliteti ku do të themohet dhe seperohet guri gëlqeror , rëra dhe zhavori gjendet në pjesën e kodrës mbi fshatin Zhur dhe kufizohet në veri me vet fshatin Polishte, në jug me Vermicë, në perëndim me Billushen .

Ne afërsi te gurthyesit me seperacion nuk ka shtëpi banimi ne perimetër 1 km

4. 2. Procesi teknologjik i gurthyesit me seperacion



Prodhimi në gurthyes me seperacion do të bëhet në bazë të kërkesave për fraksione të blerësve, në bazë të cilave bëhet edhe plani i biznesit të Kompanisë. Prodhimi në gurthyes me seperacion bazohet në prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, e fraksioneve për agregat betoni, agregat asfalti dhe elementeve të betonit (kubzat dhe gypat e betonit). Ne vijim po japim përshkrimin e procesit teknologjik komplet të

gurthyesit me seperacion për prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, për agregat betoni, agregat asfalti dhe elementeve të betonit (kubzat dhe gypat e betonit).

Guri gëlqeror nga kamionët derdhet në bunkerin pranues të gurëthyesit ose nga deponia me anë të lopatës ngarkuese derdhet në bunkerin (furtinën) pranues e shënuar me nr. 1, të gurëthyesit të cilin ne kemi dhen në shemen teknologjike, mandej me anë të dhënësit vibrues (dozatorit) nr. 2, ushqehet thërmuesja primare me nofullore nr. 4, transportuesi shiritor nr. 3 është i dedikuar të bart materialin steril që ndahet nga guri gëlqeror përmes vrimave që janë të vendosura ne dhënësin vibrues, në këtë mënyrë bënë pastrimin e gurit gëlqeror që do të thërmohet në gurëthyesin me seperacion dhe të përgatis fraksionet për aplikim sa ma të mirë në ndërtimtari të ulët dhe të larët, nga thërmuesja primare me nofulla nr. 4, fraksioni 0-150mm me transportues shiritor kryesor nr. 5, transportohet në transportues shiritor të pjerrt nr. 6 , nga ku fraksioni 0-150mm përmes transportierit shiritor me magnet nr.7 (në të cilin ndahen pjeset metalike eventuale) dërgohet ne thërmuesen sekondare me qekiqa nr. 8, materiali i thërmuar përmes transportierit shiritor nr.9 fraksioni +60mm dergohet në deponit adekuate për këtë fraksion, kurse përmes transportierit shiritor nr.10 dërgohet ne sitën vibruese nr.11 me kater etazha per pes fraksione dhe ate për fraksionet +0-4 mm, +4-8 mm, +8-16 mm, +16-31.5 mm dhe + 31.5mm nga

sita vibruese nr. 11, përmes shiritit transportues nr. 12, fraksioni i prodhuar +0-4 mm transportohet në deponin adekuate, përmes shiritit transportues nr. 13, fraksioni i prodhuar +4-8 mm transportohet në deponin adekuate, përmes shiritit transportues nr. 14, fraksioni i prodhuar +8-16 mm transportohet në deponin adekuate, përmes shiritit transportues nr. 15, fraksioni i prodhuar +16-31.5 mm transportohet në deponin adekuate, përmes shiritit transportues nr. 16, fraksioni i prodhuar +31.5 mm transportohet në deponit adekuate .

Renditja dhe lidhshmëria e pajimeve dhe stabilimenteve në mes veti të cilat nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror shihet në shemën teknologjike në vijim.



Menaxhimi i procesit teknologjik bëhet nga dhoma e cila është e ndërtuar afër gurthyesit e në të cilën janë të vendosur ormani me tërë automatiken dhe mbrojtësit për tërë hargjuesit e energjisë elektrike, si dhe pulti komandues i cili është i vendosur në ormanin adekuat të caktuar për te.

Automatika do të rregullohet në atë mënyrë që mundëson lëshuarjen në punë të pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike dhe manuale. Në pultin komandues do të ekzistojnë rregullatori komandues për zgjedhjen e punës së gurthyesit me seperacion. Nëse zgjedhim punën automatike, atëherë për fillimin e startimit të pajimeve të gurthyesit me seperacion, pajimet lëshohen në punë automatikisht, duke filluar nga më të largëtat kah të afërmet, nga transportierët për fraksion finale, pasandaj sita vibruese,

transportieri shiritor, gurthyesin sekondar, transportierët shiritor tjerë, thërmuesen primare me nofulla, transportieri shiritor dhe në fund dozuesin vibrues.

Te ndalesa e pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike, pajimet ndalen me radhë në anën e kundërt të lëshimit të pajimeve duke filluar nga dozuesi vibrues e tutje.

Të zgjedhja e punës në mënyrë manuale, pajimet lëshohen në punë secila në vete, përmes tastereve të veçanta, sipas zgjedhjes ton, gjithashtu edhe te komanda manuele duhet respektuar radhën, e lëshimit të pajimeve në punë, sikurse të mënyra automatike. Udhëheqja manuele preferohet vetëm në raste të defekteve, dhe në raste të remontit të pajimeve.

Në këtë mënyrë, me anë të këtyre proceseve teknologjike në gurëthyesin me seperacion mund të prodhohmë këto fraksione nga guri gëlqeror (vetëm se duke i ndrruar sitat me hapje të ndryshme se qfar fraksioni deshirojm te prodhojm): fraksione për tampon të rrugëve, fraksione për beton dhe fraksione për prodhim të asfaltit të cilat do të i paraqesim më poshtë.

Fraksionet e tamponit të rrugëve 0 – 31.5 mm, 0 - 60 mm dhe 0 - 100mm

Fraksione e Betonit 0 - 4 mm, 4 - 8 mm, 8 - 16 mm, 16 – 31.5

Fraksionet e asfaltit 0-2 mm, 2- 5 mm, 5-8 mm, 8 - 11 mm, 11 - 16 mm, 16-22 mm

Pajimet në gurëthyes me seperacion aktivizohen me anë të energjisë elektrike ku pronari e ka të ndërtuar trafon dhe rrjetin elektrik me mjete personale. Por për shkak të ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike investitori do të pajiset edhe me një gjenerator për aktivizimin e pajimeve teknologjike, gjithashtu ne kte lokacion pronari planifikon të e ndërtoj ofiçinën për mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese si dhe pajimeve prodhuese. Përveç pajimeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për thërmimin dhe seperimin gurit gëlqeror dhe shërbimeve tjera kompania do të disponoj mekanizëm ngarkues dhe transportues si.psh. tri lopata ngarkuese, dy ekskavator, gjashtë kamionë etj. Ndërtesën për personelin e kompanisë dhe mbajtjen e pjesëve rezervë, si dhe trafon dhe gjeneratorin për furnizim me energji elektrike.

5. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis

5.1 Ndikimet në ajër

Në aktivitetin e gurëthyesit me separacion, si ndikim negativ në mjedis shprehet në ajër. Hartuesi i këtij raporti vlerëson se nga teknologjia në prodhim lirohen grimcat e mëdha të pluhurit të cilat tentojnë të gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës, dhe depozitohen në afërsi të gurëthyesit me separacion, kurse pluhurat me përbërje të elementeve kimike që posedon vetë lënda minerale, thërmitë më të vogla të cilat i bartë ajri për shkak të relievit dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca më të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me

qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit.

Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës, por duke iu falënderuar formës së relievit, konfiguracionit të terrenit, largësisë si dhe pozitës së lokacionit ku janë të vendosur gurëthyesi me separacion, bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrin deri te vendbanimet e banuara më të afërta.

Përbërja e gurit gëlqeror në shfrytëzim nuk përmban materie të rrezikshme për shëndetin e njeriut.

Gjatë realizimit të procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, ndikime negative në ajër ndodhin edhe nga:

